



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

---

**V E N D I M**

**Nr. 52 Datë 21.06. 2007**

Njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes 75.006 % të aksioneve në Bankën Popullore nga shoqëria Societe General S.A”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e :

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Zt. Lush Përpali Zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Zt. Koço Broka Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21 .06 .2007, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Njoftimi për përqendrimin e realizuar nëpërmjet shitblerjes të 75.006 % të aksioneve nga Banka Popullore tek Societe General S.A.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e Ndërmarrjeve” nenet 53-56, 58, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit dhe mundësinë për njoftim të thjeshtuar” dhe Formulari “Për njoftimin e Përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të njoftimit të përqendrimit,

**V Ë R E N S E:**

1. Societe General S.A, blerësi i pjesës prej 75.006 % të kapitalit aksionar të Bankës Popullore, është shoqëria kryesore e Grupit Societe General,

- me seli në Paris, Francë. Societe General S.A, sipas statutit dhe në përputhje me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme për institucionet e kreditit, është i autorizuar të ushtrojë veprimtari bankare, shërbime të investimit, si dhe të veprojë si agjent në fushën e sigurimeve.
2. Për vitin 2006, xhiro në tregun ndërkombëtar e Societe General është 22 417 milion Euro= 2 757 291 000 000 lekë<sup>(1)</sup>
  3. Banka Popullore Sh.A, shitësi, i pjesës prej 75.006 % të kapitalit aksionar të Bankës Popullore është institucion financiar, i themeluar në dhjetor 2003, sipas ligjit për shoqëritë tregtare. Banka Popullore është pjesë e sistemit bankar, e licensuar si bankë, me vendimin nr.17, datë 16.02.2004, nga Banka e Shqipërisë. Selia e saj është në Tiranë dhe ka 31 degë, duke u shtrirë pothuajse në të gjithë tregun kombëtar. Kapitali themeltar i B.P përbëhet nga 1.474.000.000 lekë, i ndara në 14.740 aksione me vlerë nominale 100 mijë lekë secili.
  4. Për vitin 2005, xhiro në tregun kombëtar e Bankës Popullore është 1 887 739 000 lekë.
  4. Transaksioni i njoftuar konsiston në shitblerjen e 75.006 % të kapitalit dhe të së drejtës së votës, të barasvlefshëm me 11.056 aksione të Bankës Popullore. Në përfundim të këtij transaksioni, Societe General do të zotërojë 75.006 % të aksioneve në B.P, ndërsa pjesa prej 24.99% të aksioneve të mbetura të kapitalit aksionar të BP, që përfaqësojnë 3.684 aksione do të zotërohen nga 9 aksionerët e saj (pronësia fillon me 0.20%-9.33%).
  5. Blerësi, Societe General merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet kontraktuale dhe ligjore të Bankës Popullore, të parashikuara në marrëveshjen e nënshkruar nga palët. Në lidhje me shitjen dhe transferimin e aksioneve nga shitësi tek blerësi, Societe General S.A në përputhje me kushtet e përcaktuara në pikën 2.2 të kontratës së shitjes do t'i paguajë shitësit (B.P) 90% të shumës menjëherë dhe 10% do paguhet pas një periudhe 18 muajshe. E gjithë vlera e shitjes prej 4.090.720 mijë lek përbëhet nga fonde të vetë burimeve të Societe General S.A.
  6. Ky transaksion, përbën përfundimin e kontrollit të një pjesë të konsiderueshme të kapitalit aksionar dhe të së drejtës së votës dhe është një përqendrim që përmbush kushtet për të qenë subjekt i shqyrtimit nga Autoriteti i Konkurrencës në përputhje me nenin 12, pika 1/a dhe b e Ligjit.

### **Vlerësimi i Konkurrencës**

7. Tregu përkatës
  - a) Tregu i produktit:

---

<sup>1</sup> Sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2006, 1 euro=123 lek. Burimi: Buletini zyrtar

1. Pranimi i depozitave bankare (në formën e depozitave pa afat, me afat ose formave të tjera të depozitave), për të cilat paguan ose jo interes;
2. Dhënie kredish, duke përfshirë kredi konsumatore dhe hipotekare, faktoringun me ose pa burime ndihme dhe financimin e transaksioneve tregtare;
3. Marrje hua të mjeteve financiare dhe blerje ose shitje për llogari të saj a për llogari të klientëve:
  - i. instrumente të tregut të parave;
  - ii. letrat me vlerë të borxhit;
  - iii. kontratat e “së ardhmes“ dhe kontratat me kusht “option“, që lidhen me letrat me vlerë të borxhit ose normat e interesit; ose që lidhen me letrat me vlerë të borxhit ose me normat e interesit; ose
  - iv. Të ofrojë shërbimin e pageseva dhe të arkëtimeve
- ç. Të ofrojë shërbimin e pagesave dhe të arkëtimeve;
- d. Të emetojë, të pranojë dhe të administrojë mjete të pagesave;
- e. Të ndërmjetësojë për transaksione monetare, përfshirë valutat;
- f. Të ushtrojë qeranë financiare;
- g. Të ofrojë shërbimin e kasave të sigurimit;
- h. Të ofrojë garanci bankare dhe garanci të tjera;
- i. Të shërbejë si agjent ose këshilltar financiar (nuk përfshihen shërbimet që përshkruhen në pikën 3/a dhe 3/b).

b) Tregu Gjeografik: : Tregu kombëtar, Rrjeti aktual i Bankës Popullore, që përfshin 31 degë të shtrira në gjithë territorin e vendit.

9. Transaksioni i shitblerjes së aksioneve të Banka Popullore në favor të aksionerit/ shoqërisë Societe General S.A, nuk ndryshon strukturën e tregut bankar. Ky ndryshim lidhet vetëm me ndryshimin e strukturës brenda B.P.
10. Nga analiza post-përqendrimit, vërehet se tregu është i hapur për konkurrencë, pa barrierra hyrëse dhe karakterizohet nga prania e konkurrentëve të fortë, me pjesë tregu të konsiderueshme dhe konkretisht në tregun e depozitave, bonove të thesarit, kredive etj., ku pjesa e tregut e zotëruar nga Banka Popullore respektivisht është: 4.06 %, 6.09 %, 4.64 %.
11. Palët pjesëmarrëse në përqëndrim ushtrojnë veprimtarinë e tyre në tregje të veçanta gjeografike dhe nuk kanë klientë të përbashkët. Në këtë kontekst përqëndrimi nuk mund të ketë efekte antikonkurrese duke qënë se në kuptimin e nenit 13, pika 1 e Ligjit, nuk rrezikon të krijojë ose të forcojë pozitën dominuese të ndërmarrjeve të përfshira në përqëndrim. Pra, nuk ka lidhje shkakësore midis realizimit të këtij përqëndrimi dhe krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

## **PËR KËTO ARSYE**

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”

### **VENDOSI:**

1. Të autorizojë, përqëndrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së pjesës 75.006% të aksioneve të Bankës Popullore në Shqipëri nga Societe General, me qendër në Paris, Francë.

1. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**Lush Përpali**

(\_\_\_\_\_)  
Zv/Kryetar

**Servete Gruda**

(\_\_\_\_\_)  
Anëtar

**Koço Broka**

(\_\_\_\_\_)  
Anëtar

**Lindita Milo (Lati)**

---

**K R Y E T A R**